



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.978/3 Prot.

Tiranë, më 14.07.2025

V E N D I M

Nr. 167, Datë 14. 07. 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.144, datë 23.06.2025 të znj. D. N., në të cilën pretendon diskriminim pa përcaktuar ndonjë shkak nga institucionet shqiptare, në lidhje me zgjidhjen e problematikës së vajzës së saj E. E.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

Referuar ankesës së depozituar pranë Komisionerit, ankuesja parashtroi se: *I nderuar Komisioner. Ju informova dhe vura në dispozicion prova themelore që dokumentojnë një rast tepër të rëndë dhe të paprecedentë të rrëmbimit/pengmarrjes ndërkombëtare, trafikimit dhe zhdukjes me forcë të fëmijës tim të mitur E., shtetase shqiptare (NID LI6026075N), që zgjat prej nëntë vitesh e gjysmë në Republikën e Qipros (pjesa greke). Rasti në fjalë përbën një formë të rëndë të diskriminimit shumëdimensional dhe të shumëfishtë, që përfshin bashkëveprim institucional shtetëror dhe ndërkufitar/transnacional në dëm të të drejtave dhe lirive themelore njerëzore të vajzës sime (dhe të miat si nënë, e vetmja ushtruese e përgjegjësisë prindërore dhe përfaqësuese e vetme ligjore e saj).*

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Përmes kësaj korrespondence, Ju kam vënë në dispozicion:

- *Pasaportën shqiptare të vajzës (e skaduar)*
- *Çertifikatën personale të vajzës të datës 09.06.2025*
- *Çertifikatën familjare të datës 09.06.2025*
- *Kartën shqiptare të shëndetit të vajzës, të gjeneruara nga portali unik qeveritar “e-Albania”.*

Këto dokumente dëshmojnë qartësisht statusin tim si nënë biologjike, e vetmja ushtruese e përgjegjësisë prindërore dhe përfaqësuese e vetme ligjore e fëmijës tim, e lindur më 26.10.2011, e regjistruar me NID L16026075N dhe me vendbanim të përhershëm në Shqipëri, në të njëjtën përbërje time familjare në adresën: Rr. e Poligonit, nr. 13, hyrja 1, ap. 11, Berat, Kodi Postar 5001. Të dhënat e sistemit shtetëror shqiptar dhe të dhënat në sistemin e-Albania përputhen plotësisht me këtë realitet.

Në dispozicion tuaj kam vendosur edhe:

- *Imazhe nga sistemi TIMS (vitet 2017 dhe 2019)*
- *Një ekstrakt zyrtar të vitit 2020, lëshuar nga z. A. L., ish-shefi Interpol Tirana*

Sistemi TIMS administrohet nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, nën varësinë e Ministrisë së Brendshme. Këto prova faktojnë fshirjen, manipulimin dhe falsifikimin e të dhënave personale të vajzës sime — përfshirë shtetësinë shqiptare, emrin e nënës, vendlindjen, qytetin e lindjes dhe të lëshimit të dokumentit, si dhe ngjyrën e syve — në shkelje flagrante të legjislacionit shqiptar dhe konventave evropiane dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave dhe identitetit personal. Këto ndërhyrje të paligjshme janë kryer për të favorizuar rrëmbimin, trafikimin dhe zhdukjen me forcë të vajzës sime në Qipro.

Gjithashtu, Ju kam dërguar:

- *Një fotografi të pengmarrësit N. E. me fëmijën tim*
- *Artikuj investigativë nga Pamfleti që mbështesin kauzën time për vajzën time.*
- *Kopjen e pasaportës sime biometrike shqiptare*

Përmes së njëjtës platformë, Ju kam paraqitur një akt gjyqësor të pavlefshëm/inekzistent të autoriteteve gjyqësore qipriote me nr. 253/2013, i përdorur në mënyrë abuzive nga autoritetet gjermane në stacionin policor të Hahn Frankfurt për të ndarë me dhunë vajzën nga unë dhe për ta dorëzuar te shtetasi qipriot N. E., (datëlindja 14.02.1983, ID: 845712, banues në adresën Alexandër the Great 3, 7350, Ormideia Larnaka / adresa alternative: Modestos Pantelis nr.9 Ormideia), i cili nuk ka asnjë atribut ligjor si prind sipas ligjeve shqiptare, qipriote apo ndërkombëtare.

Shtetasi qipriot N. E., është autori përgjegjës parësor i kryerjes së martesës fiktive qipriote, juridikisht e pavlefshme/inegzistente (sikurse ju informova edhe në telefonatën tonë) dhe falsifikimit të të dhënave personale të mia dhe të fëmijës tim si dhe për regjistrimin e së miturës në Qipro në mënyrë të paligjshme.

Ndër dokumentet më alarmante që dëshmon shitjen e fëmijës tim me bashkëpunimin e instancave shtetërore shqiptare, dhe që solli rrëmbimin/pengmarrjen ndërkombëtare, trafikimin dhe zhdukjen me forcë të së miturës shqiptare prej nëntë vite e gjysmë në Republikën e Qipros, është edhe një akt fals gjyqësor, juridikisht i pavlefshëm (i bashkëngjitur), i supozuar si 'vendim për lënie rritje dhe edukim të fëmijës' i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i cili nuk ekziston në regjistrin elektronik gjyqësor të Republikës së Shqipërisë.

Mos-ekzistencën e këtij 'vendimi' e dëshmon hapur edhe fakti se në aktet e gjendjes civile shqiptare, e mitura E. figuron në të njëjtën përbërje familjare me nënën dhe pjesëtarët e tjerë të familjes së saj legjitime (Kodi Civil nenet 8, 12, 13; Ligji nr. 10129 "Për Gjendjen Civile" nenet 6, 15/2, 31, 35; Kodi i Familjes nenet 215, 216, 227, 232). Pra, një fëmijë i mitur që rezulton se jeton me nënën/prindin e vetëm ligjor, prej nëntë vite e gjysmë nuk ndodhet as me nënën dhe as në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky dokument jo vetëm që shkel të drejtat procedurale më elementare, por përbën një akt flagrant të falsifikimit zyrtar dhe të shpërdorimit të funksionit publik nga ana e gjyqtarës R. P., dhe bashkëpunëtorëve të tjerë institucionalë të kësaj gjykate, të Ministrisë së Drejtësisë shqiptare dhe të Ministrisë së Drejtësisë së Qipros.

Në këtë akt të paligjshëm si nga forma dhe nga përmbajtja, në kundërshtim me çdo të dhënë civile të regjistruar në Shqipëri dhe Qipro, statusi im civil figuron i falsifikuar si 'e martuar' dhe më pas si 'e divorcuar' nga një martesë qipriote juridikisht e pavlefshme dhe inekzistente, e cila nuk ka qenë kurrë e regjistruar në regjistrin civil shqiptar apo atë qipriot. Më tej, dokumenti më stigmatizon si "rrëmbyese" e vajzës sime të mitur, në mungesë të çdo vendimi penal të formës së prerë, në kundërshtim me të drejtën e pafajësisë dhe me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare të një procesi të rregullt ligjor.

Ky akt përbën një dëshmi konkrete të manipulimit institucional të pushtetit gjyqësor në funksion të një skeme të mirëorganizuar të diskriminimit dhe dhunës gjinore, kombëtare, identitare, sociale, familjare dhe institucionale ndaj një nëne shqiptare dhe të miturës së saj, me pasoja të drejtpërdrejta në zhdukjen me forcë, trafikimin dhe mbajtjen peng të fëmijës shqiptare në një shtet të huaj.

Ky rast bie në kundërshtim flagrant me të drejtën kombëtare shqiptare, qipriote, me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe me një sërë instrumentesh ndërkombëtarë detyrues për të gjitha shtetet palë.

Nga pikëpamja juridike dhe faktike, kjo situatë përbën jo vetëm mohim ekstrem të të drejtave themelore të fëmijës dhe të nënës si përfaqësuese ligjore e vetme, por gjithashtu përfaqëson një shkelje të rëndë dhe sistematike të parimeve themelore të shtetit të së drejtës dhe të standardeve të së drejtës ndërkombëtare publike dhe evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Të gjitha informacionet e mësipërme përbëjnë një bazë solide faktike dhe ligjore për nisjen, kryesisht dhe me karakter urgjent, të procedurës administrative nga institucioni që Ju drejtoni, në përputhje me detyrimet tuaja kushtetuese dhe ligjore, në funksion të mbrojtjes nga diskriminimi i rëndë dhe sistematik që është kryer ndaj meje dhe vajzës sime nga autoritete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Z. Komisioner! Në Udhëzimin e përbashkët nr. 463, datë 30.07.2020, në pikën 44 të tij, është sanksionuar se: "Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përputhje me nenin 32, pika 2 të Ligjit nr. 10221/2010 'Për mbrojtjen nga diskriminimi', ka akses në sistemin elektronik të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile për të marrë të gjitha të dhënat e domosdoshme në lidhje me përbërësit e gjendjes civile të shtetasve, të cilat konsiderohen të nevojshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj në ushtrimin e kompetencave të institucionit, të vlerësuara në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë."

Në përputhje me këtë dispozitë dhe kompetencat tuaja ligjore, kërkoj gjithashtu që institucioni Juaj të ushtrojë drejtpërdrejt aksesin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, për të verifikuar dhe administruar të dhënat autentike në lidhje me statusin civil timin dhe të vajzës E., në funksion të hetimit administrativ për diskriminim institucional dhe shkelje të të drejtave themelore të njeriut. Të dhënat në fjalë mund të merren si në mënyrë shkresore, ashtu edhe elektronikisht, në përputhje me formën dhe qëllimin e procedurës.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri:

- Të më komunikoni me shkrim pranimin dhe regjistrimin e kësaj kërkesë.
- Të më njoftoni për çdo masë të marrë për parandalimin e vazhdimin të këtij krimi të rëndë ndërkombëtar ndaj fëmijës sime.
- Të ndërhyjnë pranë Policisë së Shtetit, Interpol Tirana dhe SPAK për:
 - a) Regjistrimin dhe trajtimin me prioritet të kallëzimeve të mia në këto nëntë vite
 - b) Futjen e vajzës në kërkim ndërkombëtar (lista e verdhë e Interpol-it) sipas neneve 280, 281 dhe 293 të KPP dhe nenit 90 të Rregullores së INTERPOL-it.
- Ndërhyrjen pa vonesë pranë institucioneve përgjegjëse dhe autoriteteve diplomatike për:
 - a) Regjistrimin dhe trajtimin me përparësi të kallëzimeve penale nga Policia e Shtetit, Interpol Tirana dhe SPAK, në përputhje me nenet 280, 281 dhe 293 të Kodit të Procedurës Penale;
 - b) Futjen e vajzës në listën e personave të humbur (Yellow Notice) dhe të N. E., dhe personave të tjerë përgjegjës të këtij krimi në (Red Notice), në zbatim të neneve 90, 82, 83 e në vijim të Rregullores mbi "Përpunimin e të dhënave" të INTERPOL-it;
 - c) Marrjen e masave urgjente nga Ambasada Shqiptare në Athinë-Greqi, për lirimin e

menjëhershëm të vajzës dhe lëshimin e dokumentit “Laissez-Passer” për kthimin e saj pranë nënës dhe familjes së saj legjitime në Shqipëri.

II. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të ankesës dhe akteve bashkëlidhur saj, KMD gjykoi se kjo ankesë duhej plotësuar me informacion vijues. Për këtë arsye, Komisioneri iu drejtua ankuses me email-in e datës 26.06.2025, por edhe me shkresën zyrtare nr. 987/1 prot., datë 30.06.2025, të cilën ia përcolli ankuses përsëri me email, pasi nga ana e saj nuk është deklaruar në ankesë asnjë adresë zyrtare për të realizuar korrespondencën me institucionin e KMD. Nga ana e Komisionerit, në funksion të plotësimit të ankesës, i është kërkuar informacioni i mëposhtëm:

- Të sqarohet qartë se cilat janë shkaqet e pretenduara të diskriminimit, në kuptim të nenit 1 të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Ky informacion duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës, i cili vërteton se ju i mbartni këto shkaqe.
- Të shpjegohet në mënyrë të qartë se si këto shkaqe kanë ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin që ju e konsideroni diskriminues. Ju lutemi të përshkruani lidhjen shkakësore midis rrethanave të paraqitura dhe pasojave konkrete që keni përjetuar për shkak të tyre.
- Në ankesën tuaj, nuk keni dhënë datën e pretenduar të diskriminimit, por dhe as datën e marrjes dijeni të diskriminimit. Në këto kushte, është e domosdoshme që të saktësoni në mënyrë të qartë dhe të plotë datën, muajin dhe vitin kur ka ndodhur ngjarja që ju e konsideroni si akt diskriminues, si dhe datën kur jeni vënë në dijeni për këtë situatë.
- Sqarime në lidhje me autoritetet shqiptare ku ju keni adresuar shqetësimet tuaja: Ju lutemi të sqaroni nëse i keni paraqitur zyrtarisht shqetësimet tuaja në ndonjë nga autoritetet më poshtë të Republikës së Shqipërisë dhe nëse po, të vendosni në dispozicion kopjet përkatëse të ankesave, si dhe përgjigjet e marra nga:
 - Policia e Shtetit (drejtori vendore, komisarjat apo sektori TIMS)
 - Ministria e Brendshme
 - Ministria e Drejtësisë
 - Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm
 - Shërbimi Konsullor i Shqipërisë në Qipro apo Gjermani
 - Institucioni i Avokatit të Popullit
 - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ju lutemi të dorëzoni kopje të dokumenteve që përmendni si prova në ankesën tuaj.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju e gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.

Sa sipër, nga ana e palës ankuese nuk u kthye asnjë përgjigje dhe nuk është plotësuar informacioni që u kërkua nga ana e Komisionerit me email-in e datës 26.06.2025, por edhe me shkresën zyrtare nr. 987/1 prot., datë 30.06.2025, të cilën ankuesja rezulton që e ka marrë, pasi ka komunikuar në rrugë telefonike por dhe me WhatsApp me përfaqësuesit e institucionit të KMD, ku edhe ka marrë shpjegime dhe orientime të nevojshme për rëndësinë e plotësimit të këtij informacioni, por edhe të ankesës.

III. Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se *“diskriminimi”* do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për një listë joshteruese shkaqesh. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën,*

shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD, të ndryshuar, përcaktohet se: *“1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në Kreun IV, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, germa a) parashikon shprehimisht se: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji...”*

Në bazë të dispozitave të LMD, të ndryshuar, ankesat e depozituara pranë KMD-së shqyrtohen nga ky institucion dhe në përfundim të procedurave hetimore Komisioneri shprehet me vendimmarrje, nëpërmjet së cilës kryesisht konstaton ose jo diskriminimin e pretenduar për një ose disa nga shkaqet e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:ç)nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Refruar ankesës dhe dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se ankuesja ka vënë në dispozicion, një kopje të kartës së identitetit të saj, një kopje të kartës së identitetit të shtetasit qipriot N. E., (*jashtë të afatit*), si dhe vendimin nr. 60, datë 15.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me të cilin është vendosur kthimi i vazhës së mitur E. E., babait të saj. Nisur nga mungesa e informacionit të nevojshëm për vlerësimin e pretendimeve të parashtruara, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar ankuses me email-in e datës 26.06.2025 dhe me shkresën zyrtare nr. 987/1 prot., datë 30.06.2025, për të kërkuar sqarime dhe dokumentacion shtesë në funksion të plotësimit të ankesës.

Pas verifikimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) konstatoi se ankesa ishte e paplotë dhe për këtë arsye, iu kërkuar palës ankuese që të sqarojë në mënyrë të qartë dhe të argumentuar shkaqet e pretenduara të diskriminimit, në përputhje me nenin 1 të Ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Gjithashtu, u kërkuar që ankuesja të tregojë ndikimin konkret dhe të drejtpërdrejtë të këtyre shkaqeve në trajtimin që ajo e konsideron si diskriminues, duke përkrahur lidhjen shkakësore midis rrethanave të paraqitura dhe pasojave konkrete të përjetuara. Ky informacion duhej të shoqërohej me dokumentacion ligjor përkatës, i cili provon se ankuesja mbart shkaqet e pretenduara dhe mbështet në mënyrë të verifikueshme pretendimet e saj.

Ndërkohë rezultoi se, ankuesja nuk ka paraqitur asnjë provë të dokumentuar që të vërtetojë se i është drejtuar zyrtarisht institucioneve të shtetit shqiptar në lidhje me pretendimet e saj, ashtu sikurse nuk ka dorëzuar kopje të ndonjë ankese/kërkese zyrtare apo përgjigje të marrë prej tyre. Të gjitha pretendimet e ngritura prej saj mbeten në nivel verbal dhe nuk janë të shoqëruara me dokumentacion mbështetës apo prova të verifikueshme në aspektin procedural dhe administrativ, që të mundësonin ndjekjen e mëtejshme të çështjes në mënyrë të strukturuar dhe të mbështetur në fakte.

Gjithashtu, rezulton se ankuesja nuk ka specifikuar në mënyrë të qartë dhe të plotë as datën e ndodhjes së ngjarjes që konsideron si akt diskriminues, as datën kur është vënë në dijeni për këtë situatë, duke krijuar kështu një mangësi të rëndësishme në aspektin formal të shqyrtimit të ankesës. I vetmi dokument zyrtar i paraqitur është vendimi nr. 60, datë 15.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ndërkohë që ka kaluar një periudhë e konsiderueshme kohe, duke qenë se në nenin 33, pika 4, shkronja “dh” të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet qartë se ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e ngjarjes ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese. Për këtë arsye, mungesa e saktësisimit të

këtyre datave thelbësore bën të pamundur vijimin e shqyrtimit të ankesës në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Sa më sipër, së pari nga ana e pales ankuese nuk është depozituar asnjë dokumentacion ligjor apo provë konkrete që të vërtetojë që mbart ndonjë shkak në kuptim të nenit 1 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Po ashtu, pala ankuese nuk ka sqaruar në asnjë moment nëse ka ndonjë shkak konkret apo si ky shkak i pretenduara për diskriminim ka ndikuar konkretisht në situatën e saj dhe cilat janë pasojat që i kanë ardhur si rezultat i kësaj gjendjeje. Mungesa e këtyre të dhënave e bën të pamundur lidhjen ndërmjet rrethanave të paraqitura dhe trajtimit të pretenduar diskriminues.

Në aspektin procedural, fillimisht pala ankuese duhet të provojë se disponon një shkak të mbrojtur nga ligji dhe se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është pikërisht ky shkak. Nëse arrihet ky nivel provueshmërie, atëherë barra e provës për të vërtetuar të kundërtën pra, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i kalon palës tjetër.

Si konkluzion nga analiza ligjore e ankesës, për shkak të mungesës së elementeve thelbësore, si identifikimi i një shkakut të mbrojtur sipas ligjit, mungesa e një lidhjeje të qartë shkak-pasojë ndërmjet pretendimeve të parashtruara dhe trajtimit të konsideruar diskriminues, mungesa e dokumentacionit mbështetës dhe provave të verifikueshme se i është drejtuar zyrtarisht institucioneve të shtetit shqiptar, si dhe mospërcaktimi i saktë i datës së ndodhjes së ngjarjes apo i marrjes dijeni për të, bënë të pamundur vijimin e procedurës administrative të shqyrtimit të ankesës. Për rrjedhojë, në kushtet kur ankuesja nuk ka përmbushur kërkesat ligjore të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, në përputhje me Ligjin nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, dhe nuk ka plotësuar kërkesën e Komisionerit për dorëzimin e informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm brenda afatit të përcaktuar, rezulton se kjo ankesë nuk përmbush kriteret ligjore për pranimin dhe shqyrtimin e saj të mëtejshëm në fazën procedurale.

Në përfundim, duhet theksuar se provave dhe fakteve konkrete janë të domosdoshme për vijimin e shqyrtimit të ankesës dhe, në mungesë të tyre, Komisioneri nuk mund të konstatojë elementë të mjaftueshëm për të vazhduar me hetimin administrativ të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga pala ankuese kundër institucioneve shqiptare, nuk mund të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur hetimin dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 7, pika 3, nenin 20, pika 1 , germa “a”, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a), nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues znj. D. N., kundër institucioneve shqiptare, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA